



Datë: 30.03.2026
Numër Protokolli: 1597/2026

A.nr.2049/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, më Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.2049/2025, të datës 19.12.2025, të parashtruar nga ankuesja F.K, kundër organit të punësimit: Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike: “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 30.03.2026, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.2049/2025, e datës 19.12.2025, e parashtruar nga ankuesja F.K.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, F.K (*tutje referuar vetëm ankuesja*), më datë 19.12.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të klasifikimit jo të drejtë të pozitës së saj Mbikëqyrës i Sektorit për Pranim, Regjistrim, Dorëzim dhe Menaxhim të Lëndëve sipas Rregullores Nr.03/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.02/24 për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civil në Administratën e Sistemit Gjyqësor, duke pretenduar që të aprovet ankesa si e bazuar dhe të rishikohet Rregullorja Nr.03/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.02/24 për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civil në Administratën e Sistemit Gjyqësor.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*) duke marr për bazë faktin se ankesa e parashtruar nga ankuesja ka për objekt shqyrtimin e Rregullores Nr.03/2025, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.02/24 për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civil në Administratën e Sistemit Gjyqësor ka gjetur se ankesa **është e palejuar, sepse:** Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesja është e punësuar në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe se e njëjta sipas Akt emërimit me numër reference 03-1321, të datës 01.07.2024,

ushtron pozitën e punës Mbikëqyrëse e Sektorit për Pranim, Regjistrim, Dorëzim dhe Menaxhim të Lëndëve, në Gjykatën Themelore në Gjilan.

Tutje, ankuesja më datë 04.12.2025, ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjedhjen e Konteksteve dhe Ankesave, pranë Sekretariatit Gjyqësor të Kosovës, lidhur me klasifikimin jo të drejtë të pozitës së saj të punës sipas Rregullores Nr.03/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.02/24 për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civil në Administratën e Sistemit Gjyqësor, ndërsa, Komisioni për Ankesa në SKGJK, përmes Akt-Përgjigjes, më numër të protokollit 09-2566, të datës 12.12.2025, ka shpallur vetën jo kompetent lidhur me kërkesën e saj duke e udhëzuar të njëjtën ti drejtohet Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si organ kompetent.

Ankuesja, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke pretenduar që pozita e sa është klasifikuar jo drejtë sipas Rregullores Nr.03/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.02/24 për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civil në Administratën e Sistemit Gjyqësor, mbi pretendimin ankimor që kjo rregullore të rishikohet dhe pozita e saj të klasifikohet në kategorinë Drejtues i Ulët 1.

Kolegji i Këshillit lidhur me të drejtën e nëpunësve civil në ushtrimin e mjeteve juridike dhe rrjedhimisht lidhur më juridiksionin e Këshillit në kuptim të shqyrtimit të ligjshmërisë së akteve të goditura me ankesë, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 27, paragrafi 3 ku përcaktohet se: *3. Nëpunësja/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil, e në ndërlidhje me këtë përcaktim ligjor e duke u bazuar në nenin 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: 1. Vullneti i organit publik në realizimin e autoritetit publik formësohet në procedurën administrative dhe manifestohet në formën e njërit prej veprimeve administrative të mëposhtme: 1.1. aktit administrativ; 1.2. kontratës administrative, apo 1.3. aktit real. 2. Procedura administrative është tërësia e renditur sipas ligjit e veprimeve procedurale dhe materiale të njëpasnjëshme të organit publik, që ka për qëllim përgatitjen dhe vendimmarrjen për një veprim konkret administrativ, shqyrtimin e mjeteve juridike administrative, si dhe ekzekutimin e aktit administrativ” Kolegji konstaton së veprimi i organit publik nënkupton aktin administrativ, kontratën administrative apo aktin real, ndërsa mosveprimi, nënkupton heshtjen administrative të organit administrativ, pra nëpunësi civil, bazuar në dispozitat e ligjit material, ka të drejtën e ushtrimit të mjeteve juridike, gjegjësisht ankesës, ndaj veprimit të organit publik, që manifestohen në formën e aktit administrativ, apo ndaj mosveprimit të organit publik (heshtjes administrative), kur pretendon se me veprimin apo mosveprimin e organit publik i janë cenuar të drejtat nga marrëdhënia e tij e punës, ndërsa, bazuar në autorizimet e dhëna me nenin 101 të Kushtetutës së Republikës së Kosova, si dhe dispozitat e nenit 6, paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli ka juridiksion që të shqyrtoj dhe të merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, në kuptim të vlerësimit të përputhshmërisë së veprimeve apo mosveprimeve të institucioneve të administratës publike me legjislacionin e aplikueshëm për shërbimin civil, por jo vlerësimin e ligjshmërisë apo përputhshmërisë së akteve të karakterit të përgjithshëm normativ me ligjin, sikurse në rrethanat e rastit konkret.*

Thënë me tepër, lidhur me natyrën e akteve nënligjore, përkatësisht rregulloreve për klasifikimin vendeve të punës, Kolegji ju referua:

- Udhëzimit Administrativ Nr.03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative, përkatësisht nenit 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.4 ku është përcaktuar se: 1.3 *“Hartim i legjislacionit” nënkupton të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me transformimin e politikave në aktet e detyrueshme ligjore të aplikimit të përgjithshëm, si dhe aktet normative që kanë të bëjnë me organizimin e brendshëm dhe funksionimin në kuadër të administratës publike; 1.4. Aktet normative përmbajnë rregullat e përgjithshme të sjelljes për një marrëdhënie juridike ose për një kompleks marrëdhëniesh, që vlejnë për një numër të pacaktuar dhe të pakufizuar të individëve, për fusha të caktuara dhe kanë veprim të shumëfishtë dhe miratohen ose nxirren nga autoriteti kompetent. Në kuptim të këtij udhëzimi administrativ akte normative përfshijnë: Ligjet dhe aktet nënligjore që nxirren në zbatim të ligjeve apo për rregullimin e fushave të caktuara në bazë të kompetencave kushtetuese dhe ligjore të bartësve të institucioneve shtetërore dhe publike,*

-Ligjit Nr. 08/L-182 për Konfliktet Administrative, në fuqi nga data 10 janar 2025, më theks të veçantë:

- Nenit 3 [Përkufizimet]: *“1. Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: 1.1. Akt nënligjor normativ - një akt, i nxjerrë në bazë të autorizimit të shprehur të një ligji të miratuar nga Kuvendi, që përcakton rregulla të detyrueshme sjellje në mënyrë abstrakte dhe të përgjithshme”.*

-Nenit 10 [Organizimi dhe Kompetenca]: *“4. Gjykata Supreme, gjykon revizionin dhe si shkallë e parë dhe e vetme, padinë për shfuqizimin e një akti nën-ligjor normativ”.*

-Nenit 13 [Llojet e padive]: *“1. Në konfliktin administrativ, paditësi mund të kërkojë: 1.6. shfuqizimin e një akti nënligjor normativ (në tekstin e mëtejme “padia ndaj aktit nënligjor normativ”).*

-Nenit 25 [Padia për shfuqizimin e aktit nënligjor normativ], *“1. Me padinë për shfuqizimin e një akti nënligjor normativ, paditësi kërkon deklarimin e paligjshmërisë të një dispozite të një akti nënligjor normativ apo të tërë aktit nënligjor normativ në tërësinë e tij dhe përkatësisht shfuqizimin e tyre. 2. Padia për shfuqizimin e një akti nënligjor normativ mund të ngrihet nëse një person fizik apo juridik pretendon se akti është në kundërshtim me ligjin dhe se për këtë shkak i cenon apo do ti cenojë në të ardhmen, të drejtat apo interesat e tij të ligjshëm. 5. Në padinë kundër aktit nënligjor normativ, i paditur, është organi publik që ka miratuar aktin.7. 18 Padia për shfuqizimin e një akti nënligjor normativ paraqitet në çdo kohë për sa akti është në fuqi, madje edhe pas miratimit por para publikimit të detyrueshëm të aktit, për efekt të hyrjes të tij në fuqi..”*

Andaj, referuar kuadrit ligjor si më sipër Kolegji vlerëson së rregulloret për klasifikimin e vendeve të punës për të punësuarit në një institucion publik, konsiderohen akte nënligjore normative dhe kanë karakter të përgjithshëm normativ dhe në rastet ku nëpunësi civil, pretendojnë së përmes aktit nënligjor i janë cenuar apo pretendohet se do ti cenohen të drejtat nga marrëdhënia e tij e punës, kundër të njëjtit akt juridik mund të parashtroj drejtpërdrejtë padi në Gjykatë Supreme si organ i vetëm kompetent që kujdeset për ruajtjen e supremacisë juridike të ligjit, përkatësisht përputhshmërisë se akteve nënligjore me ligjin.

Kështu që, duke qenë se objekt i kësaj ankese është shqyrtimi i ligjshmërisë së Rregullores Nr.03/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.02/24 për Klasifikimin e Vendeve të Punës për Nëpunësit Civil në Administratën e Sistemit Gjyqësor, akt ky nënligjor me karakter të përgjithshëm normativ, dhe nisur nga konstatimi si me lartë se vlerësimi i ligjshmërisë së akteve nënligjore me karakter të përgjithshëm normativ është kompetencë e Gjykatës Supreme të Kosovës, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin se ankesa A.nr.2049/2025, e datës 19.12.2025, është e palejuar në kuptim të nenit 129, paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe se në mbështetje të nenit 18, paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
A.nr.2049/2025

Merlinda RAMAJ

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, F.K;
- SKGJK-së: Drejtorit të Përgjithshëm dhe NjBNJ;
- Arkivit të KPMSHCK- së.